



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Nr. 305 Prot.

SENATI AKADEMIK

Durrës më, 03/03 /2021

V E N D I M

Nr. 11 Datë 03/03 2021

**“Për hapjen e dy kurseve të reja të formimit profesional, në Departamentin e Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë në Fakultetin e Studimeve Profesionale në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të nenit 71, paragrafi 1 dhe neni 81 të ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, të vendimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale nr. 2 date 02.02.2021, të shkresës nr. 69 datë 08.02.2021, të Dekanit të Fakultetit të Studimeve Profesionale, Senati Akademik,

**V E N D O S I:**

1. Për miratimin e hapjes së dy kurseve të reja të formimit profesional në Departamentin e Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë në Fakultetin e Studimeve Profesionale.
  - ✓ Kurset e trajnimit bazik për detarët sipas konventës STCW
  - ✓ Kurset e trajnimit bazik për detarët sipas konventës STCW-F
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - ✓ Zv. Rektoret
  - ✓ Dekani i Fakultetit
  - ✓ Drejtuesi i Njesisë Bazë
4. Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**  
**Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

